



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 pika 10, neni 22, neni 23 paragrafi 1 dhe neni 82 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019), neni 40 dhe Neni 41 i Rregullores së Punës të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) në seancën e 87 -të të KSHPK -së të mbajtur më 01.06.2023 të morri

VENDIM

Procedura për kontrollimin e të dhënave mbi statusin e pronës nga fleta anketuese - -----, Kryetari i Gjykatës Themelore -----, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm sipas lëndës me numër 08-3669/1 të datës 04.10.2021.

Lënda me numër 08-3669/1 datës 04.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-3669 / 1 të datës 04.10.2021 u formua me iniciativën e vet, në përputhje me Planin Vjetor për monitorimin e gjendjes dhe interesave të pronës për vitin 2021.

KSHPK krijoi lëndë për verifikimin e të dhënave mbi gjendjen pronësore nga fleta anketuese i _____, Kryetar i Gjykatës Themelore _____.

KSHPK-ja nga personi i emëruar kërkoi informacione për anëtarët e familjes së tij me të cilët jeton në një familje të përbashkët.

_____, paraqiti informacion për anëtarët e mëposhtëm të familjes së tij:

- _____ – baba;
- _____ – nëna;
- _____ – bashkëshortja;
- _____ – djali;
- _____ – vjaza;

KSHPK-ja, për pasurinë e _____ dhe për pasurinë e anëtarëve të familjes së tij në listë, ka marrë të dhëna nga Agjencia e Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Depozita Qendrore e Letrave me Vlerë dhe Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas shqyrtimit të të dhënave të marra nga institucionet kompetente dhe krahasimit të tyre me të dhënat nga fleta anketuese e _____, KSHPK-ja nuk ka konstatuar se personi i përmendur posedon pasuri që nuk e ka deklaruar dhe se ai apo familjarët e tij kanë fituar pronë joproporcionale.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: A.Ç., udhëheqës i njësisë
Miratoi: NB, anëtar i KSHPK - së

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN EKORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Katica Nikolovska**